



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 977/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Ferizaj, paraqitur kundër Bashkim Fazliut – Kryetar i Nismës Qytetare për Ferizaj (NQF), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, në rrjetin social FB, në Raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, kështu që Bashkim Fazliut - Nisma Qytetare e Ferizajt (NQF) dega në Ferizaj, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 250 (dyqindpesëdhjetë ) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 01.12.2013, nga subjekti politik PDK, ku theksohet se me datë 01.12.2013, ditën e votimit për balotazh për kryetar komune, partneri i koalicionit LDK-NQF, Bashkim Fazliu – Migjeni, përmes rrjetit social Facebook, ka shpërndarë një deklaratë me të cilën ka bërë shpifje dhe fyerje publike kundër Elmi Reqica – Shef i Shtabit Zgjedhor, duke përdorur fjalë fyese dhe shantazhuese, kërcënuese, me të cilin veprim nxit urrejtjen mbjellëse dhe luftënxitëse, dhe në të njëjtën deklaratë bën ftesë publike për të përkrahur kandidatin e LDK-së, për kryetar komune Muharrem Sfarqa. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se me këto veprime janë shkelur dispozitat e ligjore të LZP-së nr.03/L-073, neni 36.1 pika b) si dhe shkeljet e Ligjit Civil kundër shpifjes dhe fyerjes nr.02/L-65, e sanksionuar me nenin 4.2 dhe nenin 5.3 të po këtij ligji. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që këto veprime të ndalohet në ditën e zgjedhjeve të sanksionohen.

Në cilësinë e provës parashtruesi i ankesës e ka bashkangjitur një fotografi si provë .

PZAP-i, e informoi kryetarin e Nisma Qytetare për Ferizaj, NQF, Bashkim Fazliu, në kuptim të Nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 02.12.2013, për ankesën që është bërë, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 03.12.2013, deri në ora 12:00, sipas afatit të caktuar, PZAP- i mori përgjigjen e kërkuar nga Bashkim Fazliu, kryetar nga radhët e NQF-së, në të cilën theksohet se, në rrjetin social Facebook postimet e shfaqura nuk kanë të bëjnë asgjë me NQF, pasi që i njëjti postim i shpreh opinionet dhe shqetësimet e mija të

mëparshme lidhur me zhvillimin e ngjarjeve në qytetin e Ferizajt dhe Kosovës për një jetë me të mirë dhe demokraci të mirëfilltë. Më tutje ka shtuar se, në postimin e përmendur në ankesë në asnjë mënyrë nuk është bërë shkelje e procesit zgjedhor, pasi që nuk është orientuar ndaj asnjë subjekti politik apo kandidati pjesëmarrës në balotazhin e 1.12.2013. Pra nga përmbajtja e postimit nuk bëhet fjalë për thirrje të prishjes së rendit publik dhe nxitjes së urrejtjes dhe fyerjes, ndërsa sa i përket personit Ilmi Reqica ai nuk ka qenë për kandidat në këto zgjedhje dhe nuk ka kurrfarë baze kjo ankesë, dhe me personin në fjalë nuk kam asgjë personale, pos që i kemi rrugët e ndara politike, dhe “lufta” në këtë postim është përmendur në kontekstin politik. Gjithashtu në përgjigje në ankesë theksohet se ky postim është përdorë nga PDK-ja në Ferizaj për të ngritur padi penale kundrejt meje për të më diskredituar publikisht dhe për të frikësuar votuesit në Ferizaj. Ata thotë kanë paraqitur në konferencë për media këtë padi në ditën e zgjedhjeve dhe pastaj jam përballë me dezinformata të shumta të përhapura në opinion vetëm për t’i çorientuar dhe për t’i vënë në panik qytetarët e Ferizajt se kinse jam arrestuar, ku për këtë keni dëshminë e ngjitur dhe storiet në televizionet kombëtare sikur Klan Kosova. Në përgjigje po ashtu theksohet se ka dhënë deklaratë edhe në Policinë e Kosovës në Ferizaj, ku i ka përmendur arsyet e lartshënuara dhe se ka potencuar se më këtë padi i është cenuar e drejta dhe liria e shprehjes së lirë edhe në facebook-un e tij privat, si dhe thotë se nga ky postim është edhe vetë viktimë nga keqpërdorimi i tij nga subjekti politik PDK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihen qartë përmbajtja tekstuale e postimit bërë nga Bashkim Fazliu Migjeni në rrjetin social Facebook, ku shihet se bën thirrje për përkrahje dhe votim të kandidatit të LDK-së Muharrem Sfarqa, ku theksohet me fjalët nxitëse se, “sot votojmë për Muharrem Svarqën, votoni kandidatin tonë” të dërguara në ditën e votimit me datë 01.12.2013, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 7.1 pika b), e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, dhe me nenin 36.1 pika b) të LZP-së, e cila përcakton bërjen e fushatën në çfarëdo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe

- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e kandidatit Bashkim Fazliu Migjeni nga Nisma Qytetare e Ferizajt, NQF është shkelur neni 7 paragrafi 1 pika “b” të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, pasi që postimi i kandidatit Bashkim Fazliu është bërë në rrjetin social Facebook, PZAP, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 977/2013 më datën 04.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala**



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*